



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:048535

Datë: 10.03.2022

Numri i dokumentit: 02795983

PS.nr.30/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEPARTAMENTI SPECIAL, me gjyqtarin Arben Hoti, në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues, Mentor Bajraktari dhe Shadije Gërguri anëtar të trupit gjykues dhe sekretaren juridike Shqipe Rexhepi, në lëndën penale kundër të pandehurit B D, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr33/21 me dt.02.07.2021 për veprën penale Cënim i përcaktimit të lirë të votuesve e paraparë dhe sanksionuar me nenin 210 KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor të dt.28.02.2022 në të cilën të ishin të pranishëm prokurori i shtetit nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës – Ilir Morina, i pandehuri B D me mbrojtësin av.Elmi Qerimi sipas autorizimit, si dhe me pjesëmarrjen e përkthyesit të gjykatës Edib Lutfiu, të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri: B D, i biri i ..., dhe ..., e gjinisë ..., i lindur me dt.... në ..., me numër personal ... i lëshuar nga MPB - RKS, i martuar, baba i tre fëmijëve, me vendbanim në fshatin ... Komuna Klllokot, momentalisht punon ... Komunës së Klllokotit, i nacionalitetit Serb.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 12.02.2021, në Kllokot, saktësisht në objektin e Komunës së Kllokotit, në cilësinë e ... të Komunës së Kllokotit, me dashje dhe me qëllim të cenimit të lirisë së përcaktimit të votuesve në zgjedhjet e përgjithshme nacionale të mbajtura me 14.02.2021 për zgjedhjen e deputetëve të Parlamentit të Republikës së Kosovës, ka kanosur seriozisht punëtorët e Komunës së Kllokotit dhe ka keqpërdorur varësinë ekonomike të qytetarit z. Z R, ka ndikuar në ta që të votojnë për subjektin politik "Lista Serbe" e evidentuar në numrin rendor 119 dhe për kandidatët e kësaj liste, me numër 1,2,5,6,7,8,9 në atë mënyrë që:

- a) ditën e incidentit, organizoi disa takime në zyrën e tij me zyrtarët e komunës, me ç' rast në secilin takim morën pjesë rreth 15-20 persona, fillimisht i njoftoi se i ka ftuar në takim për shkak të zgjedhjeve që do të mbaheshin pas dy ditësh duke i urdhëruar që për subjektin politik duhet të votonin ' "Listen Serbe" me numër 119, ndërsa për kandidatët duhet të votonin kandidatët e preferuar të tij, me numrat zgjedhor 1,2,5,6,7, pastaj zyrtarin D V e urdhëroi që të mbaj procesverbal për evidentimin e secilit të pranishëm, kurse nga të pranishmit kërkoi që të deklarohen se nga sa vota i kanë në familjet e tyre dhe gjersa zyrtari V po i evidentonte të dhënat, ai mori një qese me lapsa kimikë me ngjyra të ndryshme dhe disa fletëvotime kopje dhe ua shpërndau të pranishmëve duke u dhënë aq fletëvotime sa kishte identifikuar votues, pastaj secilit i dha një laps kimik me ngjyra të ndryshme, si: ngjyrë të kuqe, ngjyrë portokalli, ngjyrë gjelbër dhe ngjyrë zezë, të cilat më pastaj i evidentoi në procesverbal duke shënuar lidhjen në mes të personit/familjes dhe ngjyrës përkatëse dhe krejt në fund i kanosi të pranishmit me fjalët se kush nuk do të votonte sipas urdhrave të tij do të ishte në luftë me të, sepse do të kishte pasoja për vendin e punës, duke e përfunduar me paralajmërimin se kishte krijuar mekanizëm që do ta identifikoj secilin person i cili nuk i bindej urdhrave të tij,
- b) ditën e incidentit, e thërret në telefon shtetasin Z R, një banor i Komunës së Kllokotit, familja e të Cilit merr ndihmë sociale nga Qeveria e Kosovës dhe Qeveria e Serbisë, të Cilit i kërkoi që të shkojë në zyrën e tij për takim, pastaj kur i Z. R shkon në zyrën e të pandehurit, i njëjti fillimisht i kërkoi Z. R që të votojë për subjektin politik ' "Lista Serbe" kurse për kandidat t'i votojë numrat 1,2,7,8,9 pastaj e nxjerr një kartelë nga xhepi i tij në të cilën ishte shkruar emri i partisë "Lista Serbe" dhe numrat e kandidatëve dhe duke ja dhënë atë Z. R i thotë se e gjithë familja e tij duhet të votojë për këta kandidat, pastaj kur Z. R filloi të parashtrijë pyetje se kush ishin këta kandidatë, i pandehuri i kishte thënë, citat: ti duhesh me dëgju, pasi unë të kam ndihmuar.... unë ju përgjigja se ti çka më ke

ndihmuar, kryetari me tha se të kam dhënë një _pako ndihmë ushqimore... me ç 'rast duke shfrytëzuar varësinë e tij ekonomike ka ndikuar në vullnetin e lirë të Z. R, si votues.

- Me këtë ka kryer veprën penale Cënim i përcaktimit të lirë të votuesve e paraparë dhe sanksionuar nga neni 210 KPRK-së.

Andaj gjykata bazuar në nenin e lartpërmendur dhe nenet 7,17,21,38,39,40,42,46,47,48,49,50, të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPRK-së, e gjykon:

DËNIM ME KUSHT

Të pandehurit B D, i caktohet dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili nuk do të ekzekutohet në rast se i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale, në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti.

Bazuar në nenin 79 par.1 të KPPRK-së të pandehurit i llogaritet koha e qëndrimit në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 12.03.2021 deri me dt.23.05.2021 në dënimin e shqiptuar, në rastin e revokimit të dënimit me kusht.

Bazuar në nenin 62 par.1 dhe par.2 të KPRK-së, të pandehurit i caktohet:

DËNIM PLOTËSUES

Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbime publike në kohëzgjatje pre 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurit B D i ndërpritet masa e sigurisë Premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin e caktuar me aktvendimin PPS 10/21 të dt.20.05.2021.

Obligohet i pandehuri qe te paguajë shpenzimet e procedure penale dhe atë paushallin gjyqësor në shumën prej 100 euro, dhe shumën prej 50 euro të cilat mjete do të barten në fondin për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afatin prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në bazë të nenit 115 të KPPRK-së në mënyrë të përhershme konfiskohen dëshmitë e evidentuara me shkronjat A, B dhe C sipas aktvendimit për sekuestrim PPS 10/21 i dt.16.03.2021.

A r s y e t i m

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzë PPS.nr.33/2021 me dt.02.07.2021, me të cilën e ka akuzuar të pandehurin B D, për shkak të veprës penale Cënim i përcaktimit të lirë të votuesve e paraparë dhe sanksionuar nga neni 210 KPRK-së.

Me datë 31.08.2021 dhe 16.09.2021, Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale, në të cilën prokurori i shtetit ka lexuar akuzën PPS.nr.33/2021 me dt.02.07.2021, ndërsa kryetari i trupit gjykues pasi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, të njëjtit i dha mundësinë konform nenit 246 par. 4 të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri B D në shqyrtimin fillestar nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, ndërsa kryetari i trupit gjykues bazuar në nenin 245 par.6 të KPPRK-së e ka udhëzuar të pandehurin dhe mbrojtësin e tij, që në afatin prej 30 ditëve ata mund të paraqesin kundërshtimet dhe kërkesat e tyre.

Mbrojtësi i të pandehurit av.Elmi Qerimi në afatin ligjorë ka paraqitur në gjykatë kërkesë për hedhje ta aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, ndaj të cilave pretendime prokurori i rastit është përgjigjur më forme të shkruar, ndërsa gjykata e shkallës së parë me aktvendimin PS 30/21 të datës 21.10.2021 ka refuzuar kërkesën për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave të paraqitur nga mbrojtësi i të pandehurit, e të cilin aktvendim e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit të Kosovës sipas mjetit të rregullt, pra ankesës, të parashtruar nga mbrojtësi av.Elmi Qerimi.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor me dt.20.01.2022 në të cilin shqyrtim mbrojtësi i të pandehurit av.Elmi Qerimi ka propozuar që shqyrtimi të shtyhet me qëllim që ai dhe i mbrojturi i tij ta shfrytëzojnë të drejtën për negociimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.

Gjykata ka aprovuar propozimin e mbrojtësit dhe ka caktuar shqyrtimin gjyqësor me dt.28.02.2022 ku në ndërkohë në gjykatë ka arritur marrëveshja për pranimin e fajësisë e datë 22.02.2022, ndërsa në seancën dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë të dt.28.02.2022 prokurori i shtetit Ilir Morina ka deklaruar, citat “ashtu siç është gjykata është informuar në bazë të kërkesës së të pandehurit me dt. 20.01.2022 ne për negocimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë ne kemi zhvilluar 2 takime lidhur me këtë çështje me dt. 14.02.2022 dhe 22.02.2022, dhe me datë 22.02.2022 kemi arritur marrëveshje për pranim të fajësisë e nënshkruar nga palët dhe ja kemi dorëzuar gjykatës. Prokurori i shtetit dhe i pandehuri i asistuar nga mbrojtësi i tij av.Elmi Qerimi kanë hyrë në këtë marrëveshje për pranim të fajësisë lidhur me akuzën me numër PPS 33/2021 dt.02.07.2021. Pika 1. Pranimi i fajësisë – i pandehuri B D me shënime si në shkresa të lëndës pajtohet të pranoj fajësinë për veprën penale Cënim i përcaktimit të lirë të votuesve e paraparë dhe sanksionuar nga neni 210 KPRK-së. Pika 2- Dënimi rekomanduar palët në negocimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë janë pajtuar që gjykatës ti propozojë që ndaj të pandehurit të shqiptohet dënimi kryesor dhe dënimi plotësues. Dënimi kryesor palët pajtohen që të pandehurit ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 vit burgim mirëpo në bazë të nenit 48 të KPPRK-së urdhërohet që ky dënim të mos ekzekutohet nëse personi i dënuar nuk kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës kohore 1 vjeçare të verifikimit. Dënimi plotësues – palët pajtohen që të pandehurit ti shqiptohet dënimi plotësues – ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose shqyrtimet publike në kohëzgjatje 1 vit nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi bazuar neni 62/1 dhe 2 i KPRK-së. I pandehuri pajtohet që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumën të cilën do ta caktoj gjykata. Pika 3- rekomandime tjera palët pajtohen që në rastin konkret ndaj të pandehurit të aplikohen kushtet nga neni 233/17 i KPPRK-së. Pika 4- konfiskimi – dëshmitë e evidentuar A, B dhe C sipas urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake PPS 10/2021 dt. 16.03.2021 i nënshtrohen konfiskimi të përhershëm dhe pas plotfuqishmërisë të shkatërrohen nga ana e policisë së Kosovës. Telefonat e listuar si në vijim që janë sekuestruar nga gjyqtari me numër PPS 10/2021 të dt. 16.03.2021 menjëherë i kthehen të pandehurit. Masa e sigurisë ndaj të pandehurit me këtë marrëveshje palët janë pajtuar që të ndërpritet masa e sigurisë premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktis vendqëndrimin e caktuar me aktvendimin PPS 10/2021 dt.20.05.2021”.

Në seancën dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë të mbajtur me dt.28.02.2022 mbrojtësi av.Elmi Qerimi, ka deklaruar, citat “në tërësi e mbështesë deponimin e prokurorit të PSRK-së sepse deri te kjo marrëveshje i kemi respektua të gjitha konditat e parapara

me KPPRK-në dhe gjatë marrëveshjes kemi konkretizuar kushtet me të cilat është arritur marrëveshje dhe është prezantuar para gjykatës. I akuzuari i ka pranuar provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe deklaratën edhe marrëveshjen e ka nënshkruar vullnetarisht, i propozojë gjykatës që këtë marrëveshje ta aprovoj”.

Në shqyrtimin kryesor të mbajtur me dt.28.02.2022 i pandehuri B D ka deklaruar, citat “e kam kuptuar dhe në plotëni – në tërësi pajtohem të gjitha të cekurat nga mbrojtësi im. Sa i përket pranimi të fajësisë kemi pas konsultime me avokatin, dhe vullnetarisht e kam nënshkruar dhe pajtohem në tërësi me falën e avokatit tim”.

Në seancën publike dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të mbajtur me datën 28.02.2022 pas shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë të paraqitur nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, të datës 22.02.2022 e cila ka të bëjë me të akuzuarin B D, për shkak të veprave penale si në aktakuzë, si dhe pas deklarimit për pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari në pajtim me dispozitat e nenit 233 par.18 të KPPRK-së, gjykata ka gjetur se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë dhe pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av.Elmi Qerimi, i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza. Gjithashtu gjykata ka konstatuar se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme që vërtetojnë faktin se i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilat ngarkohet me aktakuzë.

Gjithashtu gjykata ka konstatuar se në shkresat e lëndës nuk ekziston asnjë rrethanë e parapare me nenin 253 par.1 dhe 2 të KPPRK-së për pushimin e procedurës përkatësisht hedhjen e aktakuzës, prandaj gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar marrëveshja mbi pranimin e fajësisë ka mbështetje ligjore dhe bazuar në nenin 233 par.2,4,5,6,8, dhe neni 18 pika 18.1, 18.2, 18.3 dhe 18.4 të KPPRK-së të njëjtën e ka pranuar dhe ka vendosur në shkresat e lëndës.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara sipas nenit 69 të KPRK-së pra rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit, ku si rrethana veçanërisht lehtësuese për të pandehurin mori marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë të lidhur në mes të pandehurit, mbrojtësit, prokurorit të shtetit dhe kryeprokurorit të shtetit, pendimin e thellë të shprehur nga ana e të tij, sjelljen e mëparshme të pandehurit, ku gjykata nuk

ka të dhëna se më parë ka qenë i dënuar për vepra penale, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Gjkata të pandehurit i shqiptoi dënim burgimi me kusht dhe dënim plotësues si në pjesën dënuese të këtij aktgjykimi (të propozuar edhe me marrëveshjen për pranimin e fajësisë) duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar mund të arrihet qëllimi i dënimit bazuar në nenin 38 i KPRK-së; të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, si dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi konfiskimin e sendeve është marrë në bazë të nenit 115 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në bazë të nenit 450 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë në bazë të ligjit nr.05/L-036

Nga sa u tha më lart u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEPARTAMENTI SPECIAL
PS.nr.30/21 dt.10.03.2022

Sekretarja juridike:
Shqipe Rexhepi

Kryetari i trupit gjykues:
Arben Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, prej momentit të marrjes së këtij aktgjykimi në Gjykatën e Apelit të Kosovës, nëpërmjet kësaj gjykate, vetëm mbi baza tjera dhe jo mbi bazën e vendimit mbi dënimin, ngase i pandehuri ka hequr dorë nga kjo e drejtë.